

# UDHA ISLAMIE


Viti XII - Nr. 1 (131), Janar, 2014

Organ i Myftinisë Shkodër

E përmuajshme Informativ-Fetare-Kulturore-Edukative

## JA RESULTALL-LLAH:

“Mos harro se shqiptarija,  
të kanë babë e të kanë nanë!”



Lavdrim Hamja, *thirrës islam*

**D**ashuria jonë për të Dërguarin e Allahut, Muhammedin (a.s) është detyrë fetare, e cila buron nga besëlidhja që çdo besimtar i kanë dhënë Allahut (xh.sh) dhe të Dërguarit të Tij (a.s).

"O i Dërguar i Allahut! Kur është kiameti? E pyeti një sahabë Pejgamberin (a.s). Ai (a.s) i tha: "Çfarë ke përgatitur për atë ditë, pasi je duke pyetur për të?" Njeriu i tha: Asgjë, përveç se e dua Allahun dhe të Dërguarin e Tij! Pejgamberi (a.s) i tha: "Njeriu do të jetë me atë që ka dashtë në këtë botë."

Sa herë që besimtarët mbli-dhen për të përkujtuar të dashurin dhe Profetin e tyre, ata nuk i ka bashkuar asgjë tjetër, vetëm se dashuria për Allahun dhe të Dërguarin e Tij. Kështu që, përherë le ta lusim Allahun, të na bashkojë në botën tjetër me Pejgamberin (a.s) për hir të këtyre tubimeve të begata.

Por, kush ishte Muhammedi i biri i Abdullahit dhe i Amines? Ai lindi në Meke, më 12 Rebiulevvel 21 prill 570. Lindi jetim, pasi babai i kishte vdekur disa muaj përpara lindjes së tij. Ndërsa edhe nëna, Aminja e la të vetëm në moshën 6 vjeçare.

U rrit në prehrin e gjyshit Abdulmutalibit deri në moshën 9 vjeç, pastaj ai ndërroi jetë dhe kujdestarin e tij e mori amanet xhaxhai, Ebu Talibi. Kushdo që e mori për ta rritur

## MUHAMMEDI (A.S) - DËSHMITARI, PËRGËZUESI, PARALAJMËRUESI, THIRRËSI PËR TEK ALLAHU DHE DRITA NDRIÇUESE

dhe ushqyer u mbush me begati dhe me mirësi, duke iu ndriçuar jeta dhe shpirti. Kushdo që e njohu e deshi dhe e respektoi. Kudo që qëndroi dhe kudo që udhëtoi, vendi pati mirësi dhe dritë prej prezencës së tij. Allahu i Madhëruar e kishte zgjedhur për ta bërë njeriun më të mirë mbi sipërfaqen e kësaj toke.

E edukoi dhe e zbukuroi me moralin më të lartë të gjithë njerëzimit. Allahu e mbrojti dhe e udhëzoi në

parë: "Lexo, me Emrin e Zotit tënd, i Cili krijoi çdo gjë..." , pastaj e urdhëroi të fillonte rrugën e ndriçimit të botës duke i thënë: "O ti i mbuluar! Ngrihu dhe tërhiqva vëmendjen (njerëzve). Madhëroje Zotin tënd. Pastroji rrobat. Largoju adhurimeve të kota. Mos jep në shkëmbim për të marrë më shumë. Dhe, duro për hir të Zotit tënd."

Kështu, Pejgamberi (a.s) ia nisi rrugës së thirrjes dhe shpëtimit të njerëzimit. Allahu e mëson-te dhe i shpallte fjalën e Tij, ndërsa Pejgamberi (a.s) e zbatonte dhe e praktikonte në mënyrën më të përsosur. Ai është shembulli ynë më i mirë dhe më i shkëlqyer, të cilin duhet ta marrim në jetën tonë të përditshme, sa të jemi gjallë në këtë botë. "Për ju, i Dërguari i Allahut është shembulli më i mirë, për ata që shpresojnë tek Allahu dhe në ditën e gjykimit."

Me të vërtetë, a është i dashuri ynë, Pejgamberi (a.s) shembulli i jetës sonë? A e marrim atë si dritë për të na ndriçuar rrugën në errësirën e kësaj bote, e cila është sprovë për ne? A e kemi Pejgamberin (a.s) udhëzues shpirtëror dhe material, në mënyrë që jeta jonë të jetë e lumtur dhe e gëzuar, si në këtë botë, ashtu

edhe në botën tjetër? A e dëshmojmë me shpirt dhe me zemër, por edhe me fjalë dhe me vepra se ai është i Dërguari i Allahut dhe se, vetëm duke e ndjekur atë kemi për të shpëtuar, veten, familjen dhe fëmijët nga ndëshkimi i rëndë i Zotit fuqiplotë.

Allahu (xh.sh) na tregon në Kur'an për jetën e Pejgamberëve të tjerë, të cilët u munduan shumë për t'i udhëzuar popujt e tyre. Kur njerëzit nuk bindeshin dhe nuk besonin,



rrugën hyjnore që kur erdhi në këtë botë. Mrekullitë e Zotit e shoqëruan gjatë gjithë jetës së tij të ndritshme. Allahu me madhërinë e tij e dërgoi dëshmitar, përgëzues, paralajmërues dhe fener ndriçues, që t'i bënte dritë botës: "O ti i Dërguar! Ne të dërguam dëshmitar, përgëzues dhe paralajmërues. Thirrës për tek Allahu dhe dritë ndriçuese."

Në moshën dyzet vjeçare, Allahu e bëri profet të Tij. I shpalli fjalën e

ata i mallkuan popujt e vet, ndërsa Pejgamberi ynë (a.s) asnjëherë nuk e humbi shpresën, por edhe kur populli i tij e torturonin dhe e gjakosnin dhe, Allahu i dërgonte melekun për ta ndëshkuar atë popull, ai lutej për ta: "O Zoti im! Fale popullin tim, se ata nuk dinë."

Allahu i Madhëruar e nderoi të Dërguarin e Tij në këtë botë duke e bërë zotërinë e bijve të Ademit, po ashtu edhe për botën tjetër e bëri ndërmjetësuesin dhe shpëtuesin e njerëzimit në ditën e llogarisë. Të gjithë njerëzit, në atë ditë të vështirë, do tu drejtohen Pejgamberëve të tyre për t'i ndihmuar dhe shpëtuar prej vështirësive të asaj dite, por përgjigjja e tyre është se ata nuk e kanë në dorë këtë gjë, pastaj të gjithë njerëzit i drejtohen Muhammedit (a.s) për ndërmjetësim dhe ai u thotë: "Po, mua më takon të ndërmjetësoj." Bie në sexhde dhe lutet, e madhëron, e lavdëron dhe falënderon Zotin e Madh, ndërsa Allahu (xh.sh) i thotë: "Ngrije kokën, O Muhammed. Kërko çfarë të duash e Unë do ta jap atë." Lutet e lutet dhe i kërkon Zotit shpëtim për ummetin e tij dhe Allahu ia plotëson lutjen, duke falur prej dënimit dhe duke e shpëtuar çdo kënd, i cili e ka njohur Zotin e tij në këtë botë.

Prandaj, nëse duam të jemi prej pjesëtarëve të ummetit të Pejgamberit (a.s) dhe nëse duam të fitojmë shefatin dhe ndërmjetësimin e tij në ditë e kiametit, patjetër le ta ndjekim dhe ta pasojmë atë në jetën tonë. Ta ndjekim dhe ta pasojmë atë me zemër duke e dashur, me fjalë duke e përmendur dhe duke ra salavat për mbi të dhe me vepra duke i zbatuar porositë e tij. Të ecim rrugës, të cilën na e shkroi dhe na e ndriçoi me heshtjen, me fjalët, me miratimet dhe me veprat e tij.

"I gjithë ummeti im do të hyjë në xhenet, përveç ai që nuk do", kështu thoshte Pejgamberi (a.s). dikush i tha: O i Dërguar i Allahut, po kush nuk dëshiron të hyjë në xhenet? Ai (a.s) tha: "Kush më bindet mua do të hyjë në xhenet, ndërsa kush më kundërshton mua, ai refuzon të hyjë në xhenet."

Ai na ka porositë duke thënë: "Ato që ju kam urdhëruar veproni sa të keni mundësi prej tyre, ndërsa ato që ju kam ndaluar largojuni plotësisht prej tyre."

"Myslimani është vëlla i myslimanit. Nuk i bën padrejtësi, nuk e zhgënjën, nuk e mashtron dhe nuk ia sjell shpinën."

"Nuk beson asnjëri prej jush, derisa të dëshirojë për vëllanë e tij, atë që dëshiron për vete."



Porositë e tij për ne janë të shumta, sepse na donte shumë dhe mendonte për hallin tonë, në atë ditë kur do të dalim për të dhënë llogari. Gjithë jetën e tij e kaloi për t'i bërë dritë njerëzimit, derisa e plotësoi kumtimin e shpalljes së Allahut (xh.sh).

Ndërsa, përpara se ai të ndërronte jetë, bëri haxhin e lamtumirës. Gjatë këtij haxhi i zbriti ajeti kuranor: "Sot përsosa për ju fenë tuaj, plotësova ndaj jush dhuntinë Time, zgjodha për ju Islamin fe". (Maide: 3). Ebu Bekri (r.a) pasi e dëgjo ai ajetin qau.

Njerëzit e pyetën se për çfarë qan, pasi edhe ky ajet është si gjithë ajetet e tjera që i kanë zbritur të Dërguarit (a.s). Tha: Ky ajet ka për qëllim Pejgamberin (a.s).

Nëntë ditë përpara se i Dërguari i Allahut të ndërronte jetë, zbriti ajeti i fundit nga Kur'ani famëlartë: "Dhe ruajuni një ditë kur në të ktheheni tek Allahu dhe secilit njeri i plotësohet ajo që e ka fituar dhe atyre nuk u bëhet e padrejtë". (Bekare: 281).

Gjendja e Pejgamberit (a.s) filloi të rëndohej. "Dua të vizitoj dëshmorët e Uhudit", kështu u shpreh Pejgamberi (a.s). Qëndroi përpara varrezave të dëshmorëve dhe tha: "Es-salam alejkum o dëshmorë të Uhudit. Ju na parapritë, por edhe ne inshaAllahu do të vijmë pas jush, madje edhe unë to të vi pas jush". Gjatë kthimit prej

varrezave, i Dërguari i Allahut qau. Njerëzit e pyetën: Përse po qan o i Dërguar i Allahut? Ai (a.s) tha: "Sa më ka marrë madhi për vëllezërit e mi!". E pyetën: A nuk jemi ne vëllezërit e tu? Tha: "Jo, ju jeni shokët e mi, vëllezërit e mi janë njerëzit, të cilët do të vinë pas meje, më besojnë mua, por pa më shikuar me sy".

Kështu, u kthye i Dërguari i Allahut. Tre ditë përpara se të ndërronte jetë, gjendja e tij u

rëndua shumë. U përpoq të ngrihej, por nuk arriti. Atëherë iu afrua Aliu (r.a) dhe Fadël ibn Abbas (r.a). Ishte hera e parë që sahabet e shohin të Dërguarin e Allahut në këtë gjendje, prandaj dhe filluan të pyesin: Çfarë i ka ndodhur të Dërguarit të Allahut, çfarë i ka ndodhur të Dërguarit të Allahut, sa që njerëzit filluan të grumbullohen.

Djersa filloi ta mbulonte Pejgamberin (a.s), sa që Aisheja (r.a) tha: Nuk kam parë kurrë asnjëri gjatë jetës sime të mbulohet në djersë në këtë formë. Merrja dorën e Pejgamberit

(a.s) dhe fërkoja fytyrën e tij, sepse dora e tij ishte më e mirë dhe më bujare se dora ime. E dëgjoja duke thënë: "La ilahe il'lallah. Me të vërtetë vdekja ka memento të vështira".

Aisheja (r.a) thotë: Gjatë kësaj kohe, në xhami u shtuan zërat dhe bisedat për gjendjen e rëndë të Pejgamberit (a.s). I Dërguari i Allahut pyeti: "Çfarë janë gjithë këto zëra?" I thanë: O i Dërguar i Allahut, njerëzit kanë frikë për ty. Tha (a.s): "Më mbartni tu dal përpara njerëzve". E mbartën dhe ashtu në atë gjendje u ngjit në minber.

Kjo është hytbeja dhe këto janë fjalët e fundit të të Dërguarit të Allahut (a.s).

"O ju njerëz, shoh se jeni të frikësuar për mua". Thanë: Po, o i Dërguar i Allahut. Tha: "O ju njerëz, takimi juaj me mua nuk është në dynja, takimi juaj me mua është te Haodi (në ahiret). Pasha Allahun, më duket sikur jam duke e parë që nga ky vend. O njerëz, pasha Allahun nuk e kam frikë për ju varfërinë, por frikë për ju kam dynjan (pasurinë), ku do të garoni me njëri-tjetrin ashtu siç kanë garuar popujt e mëparshëm dhe, t'iu shkatërrojë ashtu siç i ka shkatërruar ata".

Pastaj tha: "O ju njerëz, kijeni frikë Allahun, kijeni frikë Allahun për namazin tuaj". E përsëriti disa herë.

"O njerëz, kijeni frikë Allahun për gratë tuaja, kijeni frikë Allahun për gratë tuaja. Ju porosis të silleni mirë me gratë".

"O njerëz, një njeriut Allahu (xh. sh) i dha për të zgjedhë mes dynjasë dhe asaj që ndodhet tek Allahu. Zgjodhi atë që ndodhet tek Allahu". Askush nuk e kuptoi qëllimin e kësaj fjale. Ai kishte për qëllim veten e tij. Ebu Bekri (r.a) ishte i vetmi që i kuptoi këto fjalë, prandaj dhe ia plasi duke qarë. U ngriti në këmbë dhe e ndërpreu Pejgamberin (a.s) duke thënë: Sakrifikuam për ty me baballarët tanë, nënat tona, me fëmijët tanë, gratë tona, me pasurinë tonë. Kështu vazhdoi të përsëriste gjithnjë. Njerëzit e vështruan me habi Ebu Bekrin, si ia ndërpret fjalën të Dërguarit të Allahut? Pejgambe-

ri (a.s) filloi ta mbrojë Ebu Bekrin përpara njerëzve duke thënë: "O ju njerëz, lëreni Ebu Bekrin, sepse nuk ka asnjëri prej jush, i cili të ketë kontribuar për ne dhe të mos ia kemi shpërblyer, përveç Ebu Bekrit, atij nuk kemi mundur t'ia shpërblejmë. Shpërblimin e tij ia kam lënë Allahut të lartësuar. Të gjitha dyert e xhamisë mund të mbyllen, përveç derës së Ebu Bekrit, ajo nuk do të mbyllet kurrë.

Përpara se të zbresë nga minberi Pejgamberi (a.s) iu lut Allahut xh.sh për myslimanët, si lutja e fundit e tij ai tha: "Allahu ju ruajt, Allahu ju bëftë strehë, Allahu ju ndihmoftë, Allahu ju forcoftë, Allahu ju mbështetë..."

Fjalët e fundit pak para se të zbresë nga minberi: "O njerëz, jepuni selam të gjithë atyre që do më ndjekin nga ummeti im deri në ditën e Kijametit".

Pastaj hyri Fatimja (r.a) bija e Pejgamberi (a.s). Sapo hyri në dhomë ajo qau, sepse i Dërguari i Allahut (a.s) nuk u çua në këmbë për ta pritur dhe për ta përqaftuar siç e kishte bërë zakon ta priste vajzën e tij sa herë që ajo vinte. Pejgamberi (a.s) i tha: "Afrohu tek unë o Fatime". I foli lehtë në vesh dhe ajo qau edhe më shumë. E thirri përsëri: "Afrohu tek unë o Fatime". I foli përsëri në vesh dhe ajo qeshi. Aisheja (r.a) tregon se pas ndërrimit jetë të Profetit (a.s) e pyeta Fatimen se çfarë të tha i Dërguari (a.s)? Ajo tha: Herën e parë më tha: "O Fatime, sonte do ndërroj jetë", kështu që qava. Por, kur më shikoi duke qarë tha: "O Fatime, ti do jesh e para prej familjes që do të më pasosh në jetën tjetër" (do jesh e para prej familjes që do vdesësh pas meje), prandaj dhe qesha).

Pastaj, Pejgamberi (a.s) tha: "Nxirri nga dhoma njerëzit" dhe më tha: "Afrohu tek unë o Aishe". U mbështet tek unë. Ngriti dorën lart dhe tha: "Në shoqëri të Lartmadhërishmit, në shoqëri të Lartmadhërishmit". E kuptova se atij po i kërkohet të zgjidhte. Dora iu lëshua dhe koka iu rëndua. E kuptova se tashmë ai (a.s)

ndërroi jetë. Nuk e dija se çfarë të bëj. Nuk pata zgjidhje tjetër, vetëm se dola nga dhoma dhe hapa derën që të çonte në xhami nga ku shiheshin njerëzit. U thashë: I Dërguari i Allahut ndërroi jetë, i Dërguari i Allahut ndërroi jetë. E gjithë xhamia u mbush duke qarë. Ali ibn Ebi Talibi ra në vend, Uthman ibn Affan filloi të bënte si fëmijë, Umer ibnul Hatabi ngriti shpatën lart dhe tha: Kush thotë se i Dërguari i Allahut ka vdekur, kam për t'ia këputur kokën. Ai ka shkuar për të takuar Zotin e tij, siç shkoi Musai (a.s) për të takuar Zotin dhe, ai do të kthehet dhe do ta vrasë atë që ka thënë se ai ka vdekur.

Ndërsa, njeriu më i përmbajtur ishte Ebu Bekri (r.a). Ai hyri në dhomë ky gjendej trupit i Pejgamberit (a.s), e përqafoi atë dhe tha: O mik i shtrenjtë, o i dashur, o i Dërguar. E puthi Pejgamberin (a.s) dhe i tha: I mirë ishe i gjallë dhe i mirë qenke i vdekur, o i Dërguar i Allahut. Pastaj doli nga dhoma dhe iu drejtua njerëzve: Kush ka qenë që ka adhuruar Muhammedin, le ta dijë se Muhammedi ka vdekur. Dhe, kush ka qenë që ka adhuruar Allahun, le ta dijë se Allahu është i gjallë dhe nuk vdes kurrë.

Shpata ra nga dora e Umerit (r.a) dhe ai tha: E kuptova se ai ka vdekur. Umeri (r.a) tregon: Dola jashtë dhe nisa të kërkoj për ndonjë vend për t'u ulur i vetëm dhe të nisi të qaj.

Pejgamberi (a.s) po varrosej dhe Fatimja (r.a) thoshte: Si ju bën shpirti dhe dora të hidhni dhe mbi fytyrën e të Dërguarit të Allahut?

Kjo ishte një përmbledhje e shkurtër nga jeta e Pejgamberit (a.s), në mënyrë që ta njohim sa më mirë jetën e tij dhe tua tregojmë dhe tua mësojmë edhe njerëzve të tjerë se kush ishte Muhammedi, i Dërguari i Allahut, i cili u dërgua mëshirë për mbarë botët.

Së fundi, çfarë do të bëjmë pas porosisë të të Dërguarit (a.s). A do të ndryshojë jeta jonë dhe, a do të kthehemi te rruga e Pejgamberit (a.s) për t'u bashkuar me të, te Haudi në ahiret dhe në xhennetin Firdeus?!

Kirk Davis Swinhart

**K**urani i Thomas Jefferson- Islami dhe Themeluesit e Kombit", të shkruem nga Z. Kirk Davis Swinhart, një studjues i cili tashti po shkruen edhe një libër mbi Sir William Johnson, diplomati britanik pranë Amerikaneve-Indiane (vendat) në shekullin 18-të. Libri, dhe botimi i recensionit, kanë shkaktue habi në mes të lexuesve amerikanë që njohin shumë pak Islamin si fe, filozofi dhe moral, ose e njohin nga shkrimet e disa autorëve anti-myslimanë.

Besoj se përkthimi shqip i këtij recensionit (dhe sidomos leximi i librit) do të sqarojë edhe për lexuesin shqiptar, gjanësinë e njohunive të Baballarëve të Kombit Amerikan, dhe aftësitë tynë me ndërtue një shoqëni ku liria, drejtësia dhe barazia në mes të gjithëve u konsakruen me një Kushtetute që, edhe sot dy shekuj e gjysëm ma vonë, vazhdon të drejtojë jetën publike amerikanë, pa prekë të drejtat themelore të qytetarëve të lirë. *Shënim i përkthyesit*).

"Me zbulue besimin e një njeriu nga librat që ai mban në bibliotekën e tij ashtë një ndërmarrje serioze. Dhe kur ky njeri rastisë me qenë Thomas Jefferson, ashtë diçka sikur të përpiqesh me gozhdue ujin në një sipërfaqe të ngurtë. Presidenti i tretë, një libër-dashës i jashtëzakonshëm kishte grumbullue afër 10.000 vllime për bibliotekën e ti. Ai ishte gjithashtu një njeri kokë-me-vete me kontradikta të pambarim, ashtu siç ishte edhe një politikan dhelpën. A

## POPULLI I LIBRIT:

### Nji kopje e Kuranit ndihmoi Thomas Jefferson-in me zhvillue një qëndrim tolerance fetare

*Shënim:* Revista javore *The New York Times Book Review*, në javën e fundit të nandorit 2013, botoi një recension të librit: **"Thomas Jefferson's Quran- Islam and the Founders"** (Alfred A. Kopf N.Y: 2013)


ka mundësi që ndonji nga librat që kishte në bibliotekë të ketë dhanë një kontribut të qëndrueshëm në përgatitjen e këtij kolosi të ditunisë? Përgjigja, siç duket, ashtë: Po!

Në librin "Thomas Jefferson's Qur'an" një libër shumë tërheqës dhe pak a shumë intrigues, autori, Profesor Denise A. Spellberg, zbulon zanafillën pjesore të tolerancës fetare amerikane në ngjarjet e një dite të vitit 1765, kur Jefferson-i, i cili në atë kohë studjonte ligjin

në Kolegjin William and Mary, bleu një kopje të përkthimit të tekstit të shenjtë të Kuranit. Jefferson-i nuk tha asnjherë se Kurani i dha formë drejtimit të politik. Megjithatë, Prof. Spellberg, një profesor i asociuem i studimeve të Lindjes së Mesme pranë Universitetit Texas, në Austin, paraqet në një mënyrë bindëse rolin qendror të këtij zbulimi. Me thanë thjeshtësisht: ajo që filloi me një interesim akademik për Ligjin dhe Besimin Islam kaloi në një tërheqje të fortë për studime kulturore, një zhvillim që e shtyni Jeffersonin me përfshi "myslimanët:" në vizionin e tij të gjanë për qytetarinë amerikane.

Libri gjurmon ngritjen e sentimentit anti-Islam në Evropën e shekullit XVI-të dhe kalimin e këtyne sentimenteve edhe në Amerikë, një shekull ma vonë. Pjesa ma e madhe e sentimentit anti-Islam, shpjegon ajo, ka zanafillën e vet në Evropën e Veriut: frika nga Perandoria Osmane (pa folë për piratët barbarë që qarkullojshin dhe grabitshin tregtarët në Mesdhe).

Por, jo të gjithë e shikojshin këtë fe, ose besimtarët e saj me mosbesim. Filozofi i madh anglez, John Locke, ashtë njëri nga ata që predikoi tolerancë dhe "barazinë qytetare" për popullsinë myslimane të Anglisë



rreth fundit të viteve 1680, si një aspekt i argumentimit të tij të guximshëm për garanci të të drejtave dhe të lirive që duhet të gëzojnë Jahudijte, Katoliket romane, dhe Protestantët jo-konformiste.

Profesor Spellberg zen me goje Locke-n si frymëzimi i Jeffersonit dhe, në faqet ma te bukura te librit, ai përshkruen gjenealogjinë e sukseseve ma te theksueme, te Jefferson-it ne mënyrë të veçantë Statutin e Lirive Fetare të Virgjinia-s (1786), një shkrim qe paraprinë Amendamentin e Parë, ndamjen e shtetit prej kishës (institucion fetar). Ne një kerkese të fortë dhe qortuese për randësinë e këtij fakti, Profesor Spellberg përpiqet me paraqite “Thomas Jefferson’s Qur’an” mbi te gjitha si një libër për mendjet tona te turbullueme mbas tragjedisë se 9 Shtatorit 2001, (në New York City). Por, suksesi i vërtetë i saj është në përcaktimin e një grupi të Themeluesvet e Kombit Amerikan – kryesisht Jefferson, Madison dhe Washington- ne rolin jo te pranuem nga te gjithë si radikale ne tolerancën e tyne te Islamit.

Një spjegim i këtillë është me të vërtetë sy-hapës! Por, është pak e vështirë me kuptue: Profesoresha e jonë tue qenë pak si e pavendosun me paraqitë subjektet e saj si aktore simpatike, ajo ndeshet në raste kur liberalizmi i tyne i tepruem është në kundërshtim me një evidence që shmobilizon.

Na thuhet vazhdimisht, për shembull, se Jefferson-i me kompani janë kampione të të drejtave të myslimanëve, por vetëm si një hipotezë, në raste e situata të tejskajshme. Për ma tepër, paraqitjet e saj nuk përmbajnë “një çmim për Islamit si një besim”. Cilësime të këtilla, megjithatë, dobësojnë forcën e librit. Me folë drejtë, Profesor Spellberg përpiqet që gjate gjithë udhëtimit të saj me ndjekë rrugën e mesme ndërmjet celebrimit dhe kritikës. Disa herë me sukses. Por, shpesh herë jo; ajo na ven në dukje mos-pajtimet me të cilat jemi familjarë,

pa ra në pozita ku të kërkojë angazhimin tonë.

Për shembull: Ne Mount Vernon, George Washington-i “deklaroi derën e hapun për punëtorët myslimanë në 1784”.

Ashtu si Jefferson-i ai “mbrojtiti të drejtat e myslimanëve”. Por, tek të dy këto personalitete është e arsyeshme me besue se ka pasë skllavë myslimanë. Dhe, ndryshe nga John Adams, (i cili nuk kishte asnjë skllav) Jefferson-i refuzoi me u bindë se ka ndonji lidhje në mes të robëve të marrun nga Piratët barbarë të Mesdheut dhe skllavërisë së zezë ku skllavët trajtohen si plaçkë. Profesor Spellberg ka te drejte: “Ajo që sot neve na duket diçka hipokrite nuk e shqetësoi Jefferson-in, ose, në të vërtetë, amerikanët e atyne ditëve”.

Ajo që mungon në këto faqe libri është një sens i thellësisë së mendimit përse Jefferson-i dhe bashkëkohësit e tij të shkëlqyeshëm ndien dhe besuen në atë mënyrë.

Fatkeqësisht, librat akademikë që trajtojnë idetë e mëdha, rrallë herë kuptojnë masat e plota të atyne që ofrojnë ide të këtilla.


Ndokush, ma i informuem me jetën e mbrendshme dhe veprimtarinë e Jefferson-it dhe Washington-it do të kishte mundë me zbulue disa pika jo konsistente me një aftësi ma të rafinueme.

Prap se prap, “Thomas Jefferson’s Qur’an” hapë horizonte të reja dhe duhet, me pak fat, të frymëzojë përpunime të matejshme”.

(Fund)

Përkthimi shqip nga:  
**Sami Repishti**

*(Ky përkthim i kushtohet nga përkthyesi ish kolegut dhe bashkëvujtesit të tij, Ismail Muçaj, besimtar mysliman i bindun, dhe admirues i filozofit anglez Thomas Carlyle. S.R.)*



**Dikush  
e pyeti Imam  
Shaaraviun:**

**Hoxhë, kur  
një popull  
bëhet i pavarur  
në vendimet  
e tij?**

**Ai e vështroi  
dhe i tha:**

**“O bir,  
ai që nuk  
ushqehet  
nga sëpata e tij,  
nuk shqipton  
nga mendja e tij!”**

**Imam Muhamed Sytari**  
Myfti i Zonës Shkodër

## NJË MBRËMJE FETARE NË GOSTIVAR, KU SHPIRTI I SALAVATEVE MBULOI HORIZONTET...

Me ftesë nga Forumi i të Rinjve Muslimanë, mbrëmjen e së shtunës, më 28 dhjetor 2013, isha ftuar të ligjëroja në një tubim masiv në qytetin e Gostivarit.

Natyrshëm, në rrobat e një thirrësi islam, dëshira për të qenë prezent në një tubim të tillë, në një qytet shqiptar, në mesin e vëllezërve të mi të një besimi, gjaku e gjuhe, ishte krejt legjitime. I shtohet edhe fakti se ftesa vinte nga Hoxha dhe vëllau i nderuar, Mr. Ahmed Mehmedi, Drejtori Përgjithshëm i FRM, me të cilin u takuam për herë të parë në Zvicër, me rastin e 10 vjetorit të FRM, në St. Gallen, disa muaj më parë.

Ndërkohë, në rrobat e Myftiut të Shkodrës, do të kisha rastin të takohesha edhe me shumë personalitete islame të vendit, në krye të cilëve, Myftiu i nderuar i Gostivarit, personaliteti i shquar islam shqiptar në këto troje, Shaqir ef. Fetahu, ligjëratorat e të cilit mbahen mend akoma në Shkodër, që nga ditët e para të

rimëkëmbjes së Thirrjes Islame pas vitit 1990, kur zotëria e tij do të kishte mirësinë, të vinte për të ligjëruar rreth vlerave islame, në sallat e Universitetit të Shkodrës.

Udhëtimi drejt Gostivarit, më dha një kënaqësi të madhe, që e munda lodhjen e rrugës, relativisht të gjatë. Kjo, për faktin se sa herë njeriut i jepet mundësia të shkelë cepat e shumtë të tokës së tij, të ndjejë aromën e natyrës, të prekë rrezet e diellit, të shijojë bukuritë e stinës e të komunikojë me vëllezërit e tij, secili në dialektin përkatës, çdo lodhje fizike kompensohet me ndjenjat e asaj fryme, që të mbush me krenari kombëtare, përzier me madhështinë e përshëndetjeve me selam e urimet me emrin e All-llahut në gojën e secilit...

Pasi kaluam nëpër Prizren, Suharekë e Ferizaj, rruga drejt Hanit të Elezit ishte akoma më e shkurtër, në prag të kalimit të kufirit me Maqedoninë, drejt Shkupit. Ishte hera e parë

që po shkelja në tokat shqiptare të shtetit përtej Kosovës, me një ftesë të tillë, ndonëse më parë, në kohët e studimeve, kur udhëtonim me autobus drejt Sirisë, natyrshëm që do të përballeshim edhe me orët e gjata të pritjes rutine, në hyrje dhe dalje të këtyre kufijve, lodhje që këmbëhej me kënaqësitë e kalimit tranzit nëpër toka shqiptare e muslimanësh shqiptarë...

Në kufi më prisnin vëllezër të dashur të FRM. Takimi ishte i përzemërt, shto edhe konsideratën reciproke që nga takimi i festës së 10 vjetorit në St. Gallen të Zvicrës... Pas një pushimi të shkurtër në Tetovë, sa për të falur namazin e iqindisë, në një xhami mrekullueshme, plot dritë e gjurmë bamirësie (e ndërtuar nga një biznesmen i vetëm musliman shqiptar), si dhe konsumimit të bisedave të para të mirësearchjes në një restorant tradicional tetovar, do të merrnim rrugën drejt qytetit, ku pas rreth dy orësh do të niste një ndër





mbrëmjet fetare më të paharrueshme për zemrën time...

Takimi në Gostivar me Hoxhë Ahmedin, më kujtoi takimin tonë të parë në St. Gallen, respektin dhe dashamirësinë që ai kishte kultivuar në mesin e të rinjve të shumtë të FRM atje, si dhe nderimin që ata i jepnin imamit dhe Hoxhës së tyre të dashur... Dhe kishin të drejtë ta bënin..! Ishin model për t'u respektuar dhe shembull, që duhet t'i shërbejë edhe qendrave të tjera islame shqiptare në diasporë, por jo vetëm!

Pas rreth dy orësh, në një prej sallave më të mëdha të qytetit, do të niste mbrëmja fetare, që na mblidhte nga shumë treva shqiptare, me fytyra të gëzuara, me përshëndetje të përzemërta dhe, me mallin e takimit pas shumë kohe, si adresë bekimi në derën e kësaj mbrëmje...

Emocionet e këtij tubiumi fetare ishin të atilla, sa të bëjnë të qëndrosh në heshtje dhe të admirosh çdo moment të tij të kaluar në një atmosferë interesimi dhe dëshire për të mësuar diçka të re, shoqëruar me një nderim dhe respekt për mysafirin, duke nisur nga i nderuari Myfti i Gostivarit, duke vijuar tek organizatori i këtij eventit e, duke vazhduar me secilin prej të pranishëmve të panumërt, që kishin tejmbushur sallën...

Tema që ishte lajmëruar në posterat e shpërndarë me këtë rast ishte: *"Përkushtimi i sahabëve ndaj Resulullahut- model inspirues për muslimanët"*. Vetëm All-llahu e di më së miri,

sesa mirësi nga shembujt e jetës së njerëzve më të mirë pas profetëve, morëm në këtë natë... Vetëm Ai e di, sesa u përmalluan zemrat, teksa së bashku në këmbë, këndonim salavate dashurie për të Dërguarin tonë... Vetëm Ai e di më së miri, sesa flade mëshironjëse u derdhën në këtë natë mbi zemrat dhe shpirtrat tanë, në shoqërinë më të mirë vëllazërore, në përkujtim të sahabëve të Resulullahut (a.s)...

Kjo mbrëmje fetare në mesin e vëllazërve të dashur në Gostivar, në aktivitetin e organizuar nga Forumi i të Rinjve Muslimanë, ngeli e paharruar në memorien time. Dhe, në shenjë mirënjohje, pata dëshirë ta dëshmoj edhe nëpërmjet shkrimit.

Gjatë saj dhe më pas, në koktejlën dhe bashkëbisedimet që zgjatën deri në prag të ndarjes nga dita e shtunë, pata kënaqësinë e madhe të diskutoj mbi tema të ndryshme të aktualitetit islam, me organizatorin e këtij tubimi të mrekullueshëm, vëllaun e nderuar, Mr. Ahmed Mehmedi dhe shumë imamë, teologë, thirrës islamë dhe aktivistë të Thirrjes Islame në trojet e ndryshme shqiptare, në Preshevë, Kosovë, Maqedoni, si dhe në Zvicër, Austri e kudo ku ata shërbejnë e punojnë me përkushtim të madh.

U ritakova me shumë prej vëllazërve të FRM në Zvicër, Austri etj, me të cilët, u ritakova në të njëjtën pikë, nga ku, para disa muajve u përshëndetëm në Zvicër...

Pata nderin të ndaj mendime dhe ide të ndryshme rreth zhvillimeve

të Thirrjes Islame në trojet tona, me mikun e nderuar, Myftiun e Gostivarit, Shaqir ef. Fetahu, burrin e urtë dhe elokuent.

I urova haxhin e këtij viti Kryetarit të FRM Zvicër, H. Sherif Roçi, që kishte marrë rrugën nga Struga për të qenë i pranishëm në këtë takim vëllazërisht e mbrëmje salavatesh.

Pata rast të takoj mualimin e nderuar nga Tetova, Abdurrahman ef. Asllani dhe një pjesë të xhematit të Hoxhës së paharruar, Jakup ef. Hasipi (rahmet pastë), me të cilët këmbuem urimet dhe lutjet më të sinqerta për mbarësi dhe suksese, në një rrugë të përbashkët, ndonëse kufijtë dhe realitetet e ndryshme materiale, na ndajnë, jashtë vullnetit tonë...

Pas shumë vitesh, ritakova vëllaun e dashur, teologun e zellshëm, Zeke-rija Rushani, që për shumë vite ka shërbyer në Medresenë e Shkodrës dhe xhamitë e saj, duke lënë një kujtim të mirë e të nderuar tek të rinjtë muslimanë në qytetin tim.

Ishte një mbrëmje, prej atyre që mbahen mend, që nuk harrohen lehtë, aq më tepër, për shpirtin e sallave dhe prekjen shqiptare të mikpritjes, bujarisë, nderimit dhe vlerësimit të mikut, vëllaut..!

Mirënjohje dhe faleminderit të gjithëve për momentet e paharrueshme!

Shkodër, 29 dhjetor 2013  
(disa orë pas kthimit...)



## Myftiu: “Ta rikthejmë traditën e salavateve pas namazeve, në xhamitë tona!”



**N**ëpërmjet hytbes së xhuma-së së parë për vitin kalendarrik diellor 2014, më 3 janar 2014, nga xhami e Parrucës, Myftiu i Shkodrës Imam Muhamed Sytari, ka vijuar për të katërtën javë radhazi, të hedhë dritë dhe të flasë mbi temën e dhikrit dhe afrimin me All-llahun (xh.sh) nëpërmjet tij.

Në qendër të hytbes së kësaj xhujmaje ka qenë salavati dhe shtimi i tij, si një urdhëresë kur'anore dhe porosi profetike.

Pas përmendjes së ajetit kur'anor, në të cilin besimtarët udhërohen të bien salavate dhe t'i dërgojnë selame Resulull-llahut (a.s), Myftiu ka përmendur edhe hadithin e Imam Ahmedit, nga Ebu Talha El-Ensari (r.a), se Resulull-llahu (a.s), doli një ditë me fytyrë të qeshur dhe e pyetëm: Të shohim të qeshur sot, o i Dërguar i All-llahut. Ai tha: “Më erdhi meleku dhe më tha: O Muhammed, a je i kënaqur që Zoti yt thotë: “Kushdo nga ymeti jot që bie një salavat përmbi ty, Unë do të bie 10 herë salavate përmbi të! Dhe kushdo nga ymeti jot që të jep selam, Unë do t'i jap 10 selame atij” Dhe unë i thashë: Pa dyshim, që jam i kënaqur!”.

Myftiu ka tëhequr vëmendjen e të pranishëmve për të shtuar sa më tepër mexhliet e dhikrit dhe salavatit nëpër xhami, si një traditë e vjetër

dhe e shëndoshë islame, që në ditët e Profetit, sahabëve dhe pasuesve të tyre.

Në hytben e tij, ka përmendur se ka ardhur koha që nëpër xhamitë tona “*ta rikthejmë traditën e bukur e të vjetër të përfundimit të virdit të pasnamazit me këndimin me xhemat të salavateve mbi të dërguarin (a.s). Mos të kemi ndrojte dhe mos të ndikohemi nga thirrjet shterpë të kujtdo që mundohet të mbysë shpirtin e xhamisë dhe atë të xhemateve tona, në emër të bidatit, sepse dhikri dhe salavatet me xhemat nuk janë bidat, përkundrazi!*” – ka përfunduar Myftiu.

Të pranishëm në faljen e xhuma-së në xhaminë e Parrucës këtë ditë kanë qenë edhe myftilerët e qyteteve Hatay dhe Iskanderun nga Turquia, që kanë mbërritur sot për një vizitë zyrtare në Myftininë e Shkodrës.

### Myftiu pret z. Nuredin Vehbi Gavoçi

**P**araditën e së hënës, më 6 janar 2014, Myftiu i Shkodrës Imam Muhamed Sytari ka pritur në zyrën e tij, z. Muhammed Nuredin Gavoçi, djali i madh i dijetarit të shquar islam shkodran, H. Vehbi S. Gavoçi, që u nda nga jeta, më 19 shkurt 2013, në moshën 90 vjeçare, në Emiratet e Bashkuara

Arabe.


Fillimisht, Myftiu i ka uruar mirëseardhjen në vendlindjen e të parëve të tij, z. M. Nuredin Gavoçi, i cili shkel për herë të parë në Shkodër e Shqipëri.

Myftiu ka folur me shumë emocion për marrëdhënien e veçantë, me të cilën Hoxha i nderuar është kujdesur për nxënësit e tij shqiptarë, që përfunduan studimet islame në Damask të Sirisë, duke i bërë shërbimin më të mirë vendlindjes së tij Shkodrës.

Njëkohësisht e ka njohur mikun nga Emiratet e Bashkuara Arabe për nderimin dhe vlerësimin që Shkodra dhe muslimanët e saj, i bënë Hoxhës së madh me rastin e ndërrimit jetë. Sikurse e ka njohur atë me titullin “Qytetar Nderi” që Këshilli i Bashkisë Shkodër i akordoi Hoxhës Vehbi S. Gavoçi, më 10 mars 2012.

Nga ana e tij, z. Muhammed Nuredin V. Gavoçi, ka shprehur kënaqësinë e tij për këtë vizitë në Shkodër, si dhe mirënjohjen e tij dhe të familjes së tij për vlerësimin e bërë për babain e tij. Ai ka theksuar se Hoxha i nderuar, gjatë gjithë kohës ka punuar për të mirën e fesë islame në vendlindjen e tij dhe në mbarë botën. Njëkohësisht ka konfirmuar se edhe në momentet e fundit të jetës, Hoxha ka lënë amanetet e tij për të mirën e Islamit në Shkodër e Shqipëri.

Me rastin e kësaj vizite, z. M. Nuredin V. Gavoçi, i ka dorëzuar Myftiut të Shkodrës një kujtim të veçantë nga orenditë personale të Hoxhës, të përdorura prej tij deri në momentet e fundit të jetës.



### 1. “Fjala e fundit që kanë zënë njerëzit nga profetësia e parë është: Nëse nuk ke turp, vepra ç’të duash!”.

Transmetuar nga Ibni Asakir në “Et-Tarikh”, nga Ebu Mes’ud El-Bedri (r.a). (Thotë Imam Menavi në “Fejdul-Kadir”: “Ka thënë El-Kadi: Kuptimi i këtij hadithi është, se ajo çfarë ka mbetur nga profetët e mëparshme dhe është ruajtur, është se turpi është frenuesi nga veprimi i veprave të pështira...” – Shih: “Fejdul-Kadir”, botimi I, Bejrut, 1996, vëll. I, fq. 62).

### 2. “Plagë e dijes është harresa, humbje e saj është ta flasësh te jo-familjarët e saj”.

Transmetuar nga Ibni Ebi Shejbe, nga El-A’mash (mursel) etj. (Thotë Imam Menavi në “Fejdul-Kadir”: “Transmeton Bejhekiu nga Vehbi, se kur Dhulkarnejni mbërriti në vendin e lindjes së diellit, mbreti i atij vendi i tha: M’i përshkruaj njerëzit. Ai ia ktheu: “Të flasësh me ata që nuk i kuptojnë fjalët e tua, është si ai që i shtron sofrë banorëve të varrezave, ose si ai që gatuan hekurin, duke shpresuar se do të nxjerrë lëng prej tij!” Ndërsa Lukmani i urtë ka thënë: “Të lëvizësh shkëmbinjtë nga vendi i tyre, është më e lehtë se të bësh të kuptojë atë që nuk kupton!”...”). – Shih: “Fejdul-Kadir”, botimi I, Bejrut, 1996, vëll. I, fq. 74).

### 3. “Ruajuni padrejtësisë, sepse padrejtësia shumëfishohet në ditën e kiametit. Ruajuni kopracisë, sepse kopracia ka shkatërruar ata që ishin para jush, i ka nxitur të derdhin gjakun dhe të legjitimojnë të ndaluarat”.

Transmetuar nga Ahmedî në “El-Musned” dhe Muslimi, nga Xhabiri (r.a). (Thotë Imam Menavi në “Fejdul-Kadir”: “Padrejtësia lind nga errësimi i zemrës, sepse nëse njeriu do të dritësohej me dritën e udhëzimit, do të largohej nga vërshimi drejt padrejtësisë. Në një transmetim nga Ibni Mes’udi (r.a), thuhet: “Zullumqarët do të merren dhe do të vendosen në një tabut (arkivol) prej zjarri, pastaj do të gjuhen në të (pra, në xhehne)...” – Shih: “Fejdul-Kadir”, botimi I, Bejrut, 1996, vëll. I, fq. 175).

### 4. “Nëse e jep zekatin e pasurisë tënde, ke larguar nga vetja të keqen e saj”.

Transmetuar nga Ibnu Khuzejme dhe Hakimi, nga Xhabiri (r.a). (Thotë Imam Menavi në “Fejdul-Kadir”: “Prej fjalëve të mrekullueshme (të dijetarëve tanë): “Çdo pasuri, që e ke ndarë zekatin e saj, ke sjellur nga vetja begatinë e saj.”). – Shih: “Fejdul-Kadir”, botimi I, Bejrut, 1996, vëll. I, fq. 321).

### 5. “Kur të dëgjoni bubullimën përmendeni All-llahun, sepse ajo s’e lëndon atë që bën dhikër”.

Transmetuar nga Tabarani në “El-Kebir”, nga Ibni Abbasi (r.a). (Në shpjegimin e këtij hadithi, komentuesi i “El-Xhamius-Sagir”, Imam Menavi thotë: “Atij, që dritat e dhikrit rrezatojnë mbi zemrën e tij, i frikësohet çdo gjë dhe i nënshtrohet çdo frikësues sa, po të dojë nënshttrimin e maleve, pa përmendur bubullimën, do t’i nënshtroheshin”. – Shih: “Fejdul-Kadir”, botimi I, Bejrut, 1996, vëll. I, fq. 476).

### 6. “Kur të ndodhë fitneja në mesin e muslimanëve, mbaj një shpatë prej druri”.

Transmetuar nga Ibni Maxheh dhe Tirmidhiu, nga Uhban El-Gifari (r.a). (Thotë Imam Menavi në “Fejdul-Kadir”: “Dmth, një shpatë prej druri, prej së cilës nuk ka dobi dhe që nuk pret. Metaforë e izolimit dhe largimit nga dyluftimi...”. Ndërsa në lidhje me transmetuesin, përmend: “Uhban ose Vehman ibni Sajji El-Gifari, sahabiu, ka transmetuar vetëm një hadith, këtë, që e ka bërë hasen Tirmidhiu...”. – Shih: “Fejdul-Kadir”, botimi I, Bejrut, 1996, vëll. I, fq. 537).

### 7. “Kur vdes njeriu, i ndërpriten veprat përveç tre rasteve: Sadekaja e vazhdueshme, dituria e dobishme dhe fëmija i mirë, që lutet për të”.

Transmetuar nga Bukhariu në “El-Edeb”, Muslimi dhe 3 (dmth, Ebu Davudi, Nesaiu dhe Tirmidhiu, vetëm), nga Ebu Hurejra (r.a). (Thotë Imam Menavi në “Fejdul-Kadir”: “(Sadekaja e vazhdueshme), si: vakëfet e hipotekuara, shpërblimi i të cilave vazhdon sa të jenë.

# 15 MINUTA ME E ALL-LLAH

(Dija e dobishme), si: mësime dhe shkrimi i librave... (Fëmija i mirë), dmth, musliman... Thotë Neveviu: “Ky është argument për saktësinë e vakëfeve dhe madhësitinë e shpërblimit të tyre.

Sikurse është sqarim rreth vendit të lartë të diturisë dhe nxitjes për ta shtuar atë dhe për ta trashëguar me anë të mësimit dhe shkrimin, si dhe përkujdesjes për të zgjedhur nga dija, më të dobishmen. Njëkohësisht argumentohet se shpërblimi i duashëm i mbërrin të vdekurit, sikurse sadekaja, me ixhma’ (pra, në mënyrë konsensuale në mesin e dijetarëve të ymetit)...”. – Shih: “Fejdul-Kadir”, botimi I, Bejrut, 1996, vëll. I, fq. 547-548).

### 8. “Kur të kalojnë pranë kopshteve të xhennetit, uluni të pushoni!”. Thanë: Cilat janë kopshtet e xhennetit? Tha: “Hallkat e dhikrit”.

Transmetuar nga Ahmedî, Tirmidhiu dhe Bejhekiu, nga Enesi (r.a). (Thotë Imam Menavi në “Fejdul-Kadir”: “Sepse gjëja më e mirë që All-llahu i ka dhënë robëve të Tij në këtë botë, është dhikri. Ndërsa gjëja më e mirë që u jep në të përtejshmen, është vështrimi në Madhë-

# TË DËRGUARIN UT (A.S.)...

rinë e Tij (xh.sh). Pra, dhikri i All-llahut në këtë botë, është si vështrimi i Tij në ahiret. Sepse ai që bën dhikër me gjuhën e tij, me prezencën e zemrës, e sheh me të brendshmen e tij (me sirrin e tij), e vështron me zemrën e tij, përpëlitet para duarve të Tij, si të ishte në

xhennet, duke pushuar në një kopësht. Thotë Neveviu: “Ashtu si është i pëlqyer dhikri, është e pëlqyer edhe ulja në mexhli-set e njerëzve të tij. Dhe për këtë, argumentet janë të bollshme”. – Shih: “Fejdu-l-Kadir”, botimi I, Bejrut, 1996, vëll. I, fq. 552).

## 9. “Kur thirrësi thërret, çelen dyert e qiellit dhe përgjigjet duaja”.

Transmetuar nga Ebu Ja’la në “El-Musned” dhe Hakimi në “El-Mustedrek”, nga Ebu Umame El-Bahili (r.a). (Thotë Imam Menavi në “Fejdu-l-Kadir”: “Dmth, kur muezini thërret ezanin për namaz, cilindro namaz, (çelen dyert e qiellit dhe përgjigjet duaja), sado që muezini është duke thirrur ezanin. Metaforë e ngritjes së perdeve, largimit të pengesave dhe pranimit të duasë...”. – Shih: “Fejdu-l-Kadir”, botimi I, Bejrut, 1996, vëll. I, fq. 556).

## 10. “Mëshironi, të mëshiroheni! Falni, të faleni! Të mjerët ata që dëgjojnë dhe nuk kuptojnë! Të mjerët ata që vazhdojnë të bëjnë gjynahe, duke e ditur!”.

Transmetuar nga Imam Ahmedi në “El-Musned”, Bukhari në “El-Edeb” dhe Bejhekiu, nga Ibni Amr ibnul-As (r.a). (942). (Thotë Imam Menavi në “Fejdu-l-Kadir”: “Ka thënë Ibni Amr ibnul-Asi (r.a): “E kam dëgjuar Resulull-llahun (a.s) t’i thojë këto fjalë nga minberi i tij”...”. – Shih: “Fejdu-l-Kadir”, botimi I, Bejrut, 1996, vëll. I, fq. 592).

## 11. “Përgatitu për vdekjen, para se të vijë vdekja”.

Transmetuar nga Hakimi, nga Tarik El-Muharibi (r.a). (Thotë Imam Menavi në “Fejdu-l-Kadir”: “Dmth, frikësoju takimit të saj, me teube...(para se të vijë vdekja), para se të të befasojë vdekja”. Ndërsa në lidhje me sahabiun transmetues të këtij hadithi, thotë: “nga Kufja, sahabi, që ka transmetuar dy a tre hadithe”. – Shih: “Fejdu-l-Kadir”, botimi I, Bejrut, 1996, vëll. I, fq. 612).

## 12. “Qëndroni të patundur në udhën e drejtë, i lumi ai që e bën! Puna juaj më e mirë është namazi dhe nuk do ta ruajë abdestin, veçse besimtari”.

Transmetuar nga Ibni Maxhe, nga Ebu Umame (r.a). (Thotë Imam Menavi në “Fejdu-l-Kadir”: “Ka thënë Ibni Abbasi (r.a): “Nuk i ka zbritur të Përzgjedhurit (a.s) ajet më i vështirë sesa: “Qëndro i patundur në udhën e drejtë, siç je urhdëruar” – (Hud: 112). Ndërsa në transmetimin e Ibn Ebi Hatemit, thuhet se, pas zbritjes së këtij ajeti, Profeti (a.s), nuk është parë më duke qeshur, asnjëherë”. – Shih: “Fejdu-l-Kadir”, botimi I, Bejrut, 1996, vëll. I, fq. 620).

## 13. “Kënaquni dhe shijojeni këtë Shtëpi...”.

Transmetuar nga Tabaraniu dhe Hakimi, nga Ibni Omeri (r.a). (Thotë Imam Menavi në “Fejdu-l-Kadir”: “Ka për qëllim shtimin e tavafeve, haxhit, umres, itikafit dhe vështrimin në vijimësi të saj... Urdhëri për shijimin, përfshin tavafin

përreth saj dhe namazin në të”. – Shih: “Fejdu-l-Kadir”, botimi I, Bejrut, 1996, vëll. I, fq. 623).

## 14. “Ata, që më së shumti më duan nga ymeti im, janë një popull pas meje. Do të dëshironte ndonjëri prej tyre të jepte familjen dhe pasurinë e tij, vetëm të më shihte”.

Transmetuar nga Ahmedi në “El-Musned”, nga Ebu Dherri (r.a). (Thotë Imam Menavi në “Fejdu-l-Kadir”: “Ky hadith është prej mrekullive të tij (a.s), kur ka folur për të panjohurën... Kjo i ka ndodhur shumë prej sufive të mëdhenj, që janë lartësuar në gradën e shikueshmërisë së tij (a.s) në vazhdimësi. Thotë Arif El-Mursi: “Pasha All-llahun, sikur të fshihej prej meje pamja e Resulull-llahut (a.s), sa hap e mbyll sytë, nuk do ta konsideroja më veten prej muslimanëve!”. – Shih: “Fejdu-l-Kadir”, botimi I, Bejrut, 1996, vëll. I, fq. 649).

## 15. “Dëshmoj pasha All-llahun dhe dëshmoj për All-llahun, sapo më tha Xhibrili: O Muhammed, pijaneci është si adhuresi i putnave!”.

Shiraziu dhe Ebu Nuajmi në “Musel-selatet” e tij, ku thotë: “Sahihun thabit”, nga Aliu (r.a). (Thotë Imam Menavi në “Fejdu-l-Kadir”: “Ka thënë Gazaliu: Një nga nxënësit e Fudejlit ra në grahmat e fundit dhe (Fudejli), u ul te koka e tij duke i kënduar suren “Jasin”. Nxënësi i tha: Mësues, mos e këndo këtë sure! Pastaj, (Fudejli) nisi t’i bënte talkin shehadetin. Nxënësi i tha: Nuk mund ta them, se jam i pastër prej tij dhe vdiq!? (Fudejli) E pa në ëndërr, teksa e tërhiqnin për në xhehne dhe e pyeti: Si arri-te deri këtu, ti ishe prej nxënësve të mi më të mirë?! Ia ktheu: Prej tre gjërave: Nga nemimja (transportimi i fjalëve në mesin e njerëzve për dashakeqësi). Nga hasedi (smira). Dhe, një herë, një mjek më rekomandoi një enë verë në vit, për një sëmundje që kisha. Dhe unë e pija!”. – Shih: “Fejdu-l-Kadir”, botimi I, Bejrut, 1996, vëll. I, fq. 655-656).

Përzgjedhi,  
përktheu nga arabishtja  
dhe përshtati në shqip

Muhamed B. Sytari



Xhahid Bushati - shkrimtar

**L**ibri më i ri i titulluar: "Nún Pasha Lapsin..." i Imam Muhamed Sytarit, Myfti i Zonës Shkodër, është një prurje e re e cilësore jo vetëm në krijimtarinë e autorit, por njëherësh pasuron korpusin e veprave të tij, bibliotekën islame dhe fondin e dijeve shqiptare.

Kënaqësia estetike, që më dha ky libër i vlefshëm e mentar, është e atillë, sa e kam të vështirë t'i shpërfaqë të gjitha vlerat që mbart ai. Libri në fjalë është i asaj natyre, që para dijeve të tilla, gjithmonë mbetesh nxënës. Kjo është dhe arsyeja që unë do të flas për disa nënvizime që kam bërë me kujdes gjatë leximit të thelluar të librit. Me këta nënvizime kam komunikuar gjatë dhe këtë -bisedë të zhvilluar në heshtje' dëshiroj ta përcjell edhe në këtë promovim libri.

Fillimisht më ka intriguar titulli: "Nún Pasha Lapsin...". Më ka bërë të mendohem... E vënë në themel të përmbajtjes kjo metaforë kuranore me vlera besueshmërie e universale, autori nuk bën gjë tjetër por receipton drejtpërdrejt me lexuesin, duke përligjur së brendshmi e njëkohësisht shpalosur shkollën e vet të "Thirrjes islame", dijet e dijetarëve e mësuesve të vet të shtrenjtë, dijet e hoxhallarëve shkodranë e më gjerë, si dhe dijet e veta. Të gjitha këto të vendosura në kontekste kohore të së djeshmes, të sotmes dhe të nesërme. Sipas mendimit tim, ky është një libër dëshmie. Autori dëshmon. Kjo nuk është e lehtë. Është sprovë e vështirë në marrëdhënie me problematikat e ndërlikuara të realitetit


## “NÚN PASHA LAPSIN...”, NJË LIBËR DËSHMIE...

që po kalojmë. Po cili është thelbi i dëshmisë së autorit Imam Muhamed Sytari? Përgjigjen e gjeta te kjo Sure, e cila thotë: "Pasha Kur'anin e pacënueshëm në urtësinë e tij të lartë". Dhe kjo është arsyeja që ky libër në mesazhet e çdo shkrimi përcjell e rrezaton nur. Është nuri i Profetit tonë, Muhamedit alej selam, drita e të cilit ngroh çdo zemër dhe njerëzimin. Porositë, këshillat dhe urtësia e Tij shpaloset madhërishtëm me kulturë e intelektualizëm qytetar nga autori i këtij libri.

Ashtu siç e përmenda më lart libri dëshmon, dhe është përballë një realiteti: ku i paafti bën prokopi e të diturit i mbushen sytë me lot, kur dhuna, grindja dhe konflikti kanë zëvendësuar ndershmërinë, kur fjala e saktë ka humbur funksionin etik e edukativ dhe është zëvendësuar me fjalën e egër e pis të rrugës, kur rendja e babëzitja pas parasë së pamerituar kanë zëvendësuar aftësinë e vizionin, progresin dhe respektin, kur servilizmi, shitja e nderit e militantizmi janë kostumi më i domosdoshëm i kësaj kohe, kur jeta dhe vlerat e saj të çmueshme kanë çmimin më të lirë edhe më të lirë se në tregjet e

gabrit, kur paqja zë një vend shumë të vogël në zemrat e njerëzve, etj., etj. Ndaj, leximi me kujdes i këtij teksti të këtij libri na fton dhe na ushqen me sofrën e begadë të virtuteve, na ushqen me besimin, me të vërtetën, me mirësjelljen, me mirësinë etj, me shumë kategori qytetarie, të cilat janë rreze të domosdoshme, ku **unë, ti, ai, ai tjetri, e plot e plot të tjerë** duhet t'ia shtrojnë vetes rrugën me diell.

Në qoftë se do të kërkojmë se cili është personazhi i librit, do të shohim se ai është i njëjtësuar me autorin, i cili në dëshminë e tij para kohës (Pasha kohën) dhe para vendit (Betohem për këtë vend) në thellësinë e fjalës, pra, në nënteksin e tij ruan dhe përcjell edhe të nesërmet të përditshmërisë së komunikimit, të lidhura me problematikat ekzistuese e me ato që të afron ardhmëria e kohës. Të gjitha këto i gjejmë të shtjelluara me finesë e me një stil elegant, faqe pas faqe te libri "Nún Pasha lapsin...". Gjithashtu nuk mungojnë edhe gjetshmëritë e këndvështrimeve të autorit, ku fokusohen në ajetet kuranore, si: Thuaj: "Ai është Allahu, Një e i Vetëm!" dhe "Përme-



nde emrin e Zotit tënd në mëngjes dhe në mbrëmje”.

Në vazhdim të nënvizimeve, më ka tërhequr vëmendjen dhe struktura e librit, e cila si bërthama ka rubrikën dhe është kompozuar sipas kësaj formule: **Parathënie - Në vend të hyrjes - Kujtesë dhe gjurmë – Me shkas – Studime – Mesazhe – Pasqyra e Hytbes (pasqyron vitet 2011, 2012 e 2013).**

Po ndalem në dy elemente të kësaj formule: Kujtesa dhe Gjurma.

Në Fjalorin e Gjuhës së sotme Shqipe, fjala kujtesë-a zërthehet kështu: Aftësia e njeriut për të mbajtur mend dhe për të riprodhuar ato që ka parë, ka dëgjuar a ka mësuar në të kaluarën. Kujtesë e fortë (e dobët). Kujtesë pamore (dëgjimore). Kujtesë logjike (mekanike). Ka kujtesë të mirë. I është dobësuar (e ka lënë) kujtesa.

\*Tërësia e përshtypjeve që ruan dikush në vetëdijen e tij për diçka që ka parë, që ka dëgjuar ose që ka mësuar në të kaluarën. Më mbeti në kujtesë. Nuk më hiqet. (nuk më shqitet) nga kujtesa. E ruaj në kujtesë. Rrëmoj në kujtesë.

\*Kujtim

\***Sa për kujtesë** sa për ta kujtuar.

Ndërsa, po në këtë Fjalor fjala gjurmë-a, -ë, -ët.; zërthehet kështu: \*Shenjë që lë shputa e këmbës së njeriut ose putra e kafshëve mbi tokë ose mbi një sipërfaqe. Gjurmë të reja (të vjetra). Gjurmë në dëborë. Gjurma e këmbës. Gjurmë kali (lepuri, ujku, ariu). Lë (mbeten) gjurmë. Prish gjurmët. Ndjek gjurmët. Eci (shkoj) pas gjurmëve. Bie në gjurmët e një kafshe. Humbas (ngatërroj) gjurmët.

.....

\*zakon. sh. Gërmadhat, rrënojat a dëshmi të tjera që kanë mbetur nga diçka që ka qenë në të kaluarën. Gjurmët e qytetit. Gjurmët e lashtësisë. Gjurmët e qytetërimit.

\*zakon. sh. fig. Përshtypje, mbresa. Gjurmë të thella në ndërgjegje. Gjurmë në kujtesë. Lë gjurmë.

Duke lënë mënjanë kuptimin e mëvetësishëm, kuptimin e parë që

shpreh tiparin thelbësor të fjalës, e më pas kuptimin e dytë e me radhë, pastaj elementet krahasuese, pastaj kuptimet e ngjyrimet metaforike, strukturat semantike, leksemat, njësitë frazeologjike, etj., etj., për këto dy fjalë që po marr në shqyrtim, po e thjeshtoj më tej skemën: \* Për Kujtesën: Më mbetet në kujtesë. Nuk më hiqet. E ruaj në kujtesë. Rrëmoj në kujtesë. \*Për Gjurmën: Lë gjurmë. Ndjek gjurmë. Eci pas gjurmëve. Humbas (ngatërroj) gjurmët.

Këto dy skema si janë mishëruar në veprën "Nún Pasha Lapsin". Këto dy nocione jetojnë e shndrisin në vepër. Sepse ajo (vepra) ka kujtesën dhe gjurmën historike. Ruan vlerat e jetëgjatësisë, të të qenurit, ekzistencës dhe të identitetit, për të cilat kemi aq shumë nevojë. Po të ndodh e kundërta, cilësojmë: Rrimë pa kujtesë dhe humbim a ngatërrojmë gjurmët. Për rrjedhojë vepra humb: para, kohësinë dhe prapakohësinë. Vepra hyn në histori pa histori. Ndërsa vepra "Nún Pasha Lapsin" i ka përjashtuar këto dukuri negative e rrezaton fisnikërisht me emblemat: Pasha kohën dhe Beto hem për këtë vend. Shfaqen në plotërinë e tyre. Përmes dëshmisë së autorit, këtu, historia flet qartë me të gjitha ngjyrat e saj, realisht dhe pa zburime e artifica. Dhe kjo është meritë e Imam Muhamed Sytarit.

Përsëri në vazhdim të nënvizimeve, e ky është i fundit. Nënvizimin e kam për stilin e autorit në këtë libër. Duke iu kërkuar ndjesë për një njohje jo të plotë të stileve të disa dijetarëve dhe autorëve nga bota arabe dhe turke; po përqendrohem te kjo vepër. Por më parë po përmend disa tipe shkrimesh, të cilat ruajnë veçanësitë e tyre, por përbashkohen, sepse është e njëjta dorë që i shkruan. Dhe ata janë: "Në shiritin e nurtë të një dite Bajrami", "Sprova e ujit dhe çmenduria e një shoqërie", "Në Zogaj, ku gurët e varrit thërrasin: "Në ishim si ju dhe ju do të bëheni si ne...", "E shkuara dhe e sotmja në atmosferën e 5-vjetorit të xhamisë së re të Parrucës", "Xhamija e Plumbit në zhgatërim", artikull i vitit 1938 që

përsërit veten akoma sot", "Hazreti Muhammedi (a.s.) – Njeriu Profet", "Teuhidi në vargjet e Hafiz Jusuf Këlmendit", "Në gjurmët e dijetarit H. Vehbi Sulejman Gavoçi - dijetari që nderon një komb, një ymet...", "Mesazh imamëve të Shkodrës në prag të Ramazanit 2012", "Për një gjallërim të ekuilibruar të moralit të fesë në shoqëri.", etj. Studimet na thonë se për të folur për stilin e një autori, siç është në rastin tonë të Imam Muhamed Sytarit, duhet të konstatojmë dhe t'i evidentojmë disa përbashkësi të opusit të tij. Në këtë rrafsh studimet mungojnë. Ne po bëjmë një përpjekje të vogël. Sipas Wolfgang Kajzerit: "Çdo vepër poetike paraqet botën e veçantë të formimit të poetit. Ta kuptosh stilin e ndonjë vepre do të thotë t'i kuptosh faktorët formësues të asaj bote në përbashkësinë e strukturës individuale". Duke marrë tharmin e këtij formulimi, e duke i shtuar edhe mendimin se -secila vepër ka strukturën e saj specifike dhe, kundruar në këtë kontekst vepra është stili.' Mbi këtë bazë, pra, ;vepra është stili', si dhe duke qenë një njohës mjaft i mirë i korpusit të veprave të Muhamedit, mund të rendis këto dukuri lidhur me stilin e tij, si: prirjen ekspressive, intensifikimin si mjet shprehës stilistik e ballafaques, përsëritjen e fjalëve e fjalive, të shumë pasazheve sintaksore si dukuri përforcimi dhe përqëndrimi të natyrës së problemit, përdorimi i tropeve, i gjuhës shqipe si element formimi e kreativiteti intelektual, qëllimshmëria e përsëritjes së motivit a të problemit në një kohë të caktuar apo në vijimësi kohore, fjalët e zgjedhura e plot ngarkesa emocionale si njësi themelore të të shprehurit, etj.

Dhe në fund: vepra "Nún Pasha Lapsin..." - një libër që duhet ta kesh në bibliotekën tënde. Dhe kjo nuk është pak.

*(referat i mbajtur në promovimin e librit, të enjten, më 26 dhjetor 2013, Shkodër.)*



Hfz. Mehas Alija

Imam në xhaminë "El-Hidaje", Zvicër

**N**ë Kur'anin Famëlartë, All-llahu i Madhëruar urdhëron: "E kur e arriti pjekurinë e tij, Ne i dhamë pushtet e dituri. E kështu Ne i shpërblejmë punëmirët" - (Jusuf 22).

Periudha e fëmijërisë është pjesa më e bukur e jetës, për të cilën thuhet se është e mbushur me plotë shëndet, rahati, gëzim e gjallëri. Në skajin tjetër të jetës, bënë pjesë pleqëria. Në këtë periudhë të shtyrë njerëzit kanë atë që në fillim të jetës së tyre nuk e kishin, e që është përvoja jetësore. Edhe përkaj kësaj përvoje që mund të fitojë njeriu, pleqëria është e tillë që të bënë të humbësh fuqinë dhe energjinë e jetës, me këtë humbje edhe dëshirën për të bërë apo ndryshuar botën që të rrethon dhe në të cilën jeton. Andaj dhe shumë shpesh i dëgjojmë më të vjetrit tek thonë: "Eh të isha sikur ti, në moshën dhe energjinë tënde, por me këto mend dhe me këtë përvojë...!".

Me gjithë këtë, përsëri, është një periudhë tjetër e jetës, ku mundemi të gjithë të kemi tërë atë potencial që është i mjaftueshëm që të mund të jemi të lumtur dhe të mbërrimë. E kjo është periudha e rinisë. Rinia shpesh merret si sinonim i shëndetit, lumturisë, fuqisë, pjekurisë, i aftësisë për të kuptuar tërë atë që kërkon jeta. Periudha e rinisë assesi nuk guxon të jetë periudhë marrëzish, e çështjesh të tjera të ndyta.

Shumë kush, po sa t'i kalojë rinia, kthehet e thotë se ajo periudhë ka qenë koha më e lumtur e jetës, porse harron se ajo kohë ishte, gjithashtu, një kohë me plotë sfida dhe stuhi për shumë çështje jetësore. Kjo periudhë, vërtetë është shumë e vështirë dhe me plotë të papritura. Njeriu në këtë kohë

## KUJDESI NDAJ TË RINJVE, NJË BORXH I MADH

duhet ta kuptojë realisht botën në të cilën jeton, dhe të ketë qëndrime të caktuar ndaj të gjithë asaj që kërkohet prej tij.

Një prej shkaqeve që përmendet kur flitet për përhapjen e fesë islame, është edhe pranimi i Islamit dhe i mësimin të tij nga ana e të rinjve. Këta ishin flamurtarët kryesor në shpjegimin dhe mësimin e Islamit.

Po ta shohim Kur'anin, dhe të studiojmë rrëfimet mbi pejgamberë dhe personalitete të tjera historike, do të shohim se Zoti punët me përgjegjësi dhe të vështira i ka vendosur në kra-hun e të rinjve.

Kur'ani vë një theks të veçantë në edukimin e të rinjve dhe të punës së tyre të rëndë fizike dhe intelektuale. Asnjëherë nuk duhet të harrohet ky fakt: njeriu edukohet, kurse kafshët stërviten. Edukimi i shëndosh, me fe e me dije, njeriut i sjell gjithmonë fat të mirë, në këtë botë dhe në botën tjetër. Në të kundërtën e kësaj, Kur'ani lajmëron se fati mund të jetë i kobshëm në botën tjetër: "O ju që besuat, ruajeni veten dhe familjen tuaj prej një zjarri, lëndë djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët" - (Tahrim, 6).

Në një koment të këtij ajeti thuhet se është detyrë e jona që, së pari, të edu-

kojmë vetveten dhe pastaj familjen, duke i urdhëruar në të mirë dhe duke i larguar nga e keqja. Pa një edukim të drejtë nuk ka as përparim fetar, moral, shoqëror, e kombëtar.

Ata që sot mundohet ta ndalojnë ezanin dhe ta njollosin atë duke e konsideruar atë si zhurmë, janë pikërisht ata që u mungon edukata e besimit dhe e respektimit të vlerave të popullit që përfaqësojnë.

Të shtrenjtët xhemat, a i kushtojmë rëndësi të mjaftueshme, qoftë si individë apo si bashkësi, arsimimit dhe edukimit të të rinjve tanë? Sa jemi të interesuar që ata të edukohen në principet e besimit të drejtë në Zotin, apo se i kemi lëshuar që ata vetë, ku të gjejnë, të edukohen?

Në mos i edukofshim ne, atëherë këtë do t'ua lëmë të tjerëve, të cilët, gjithsesi, do t'i bëjnë për vete. Prandaj dhe është e domosdoshme që t'i ndihmohet kësaj kategorie shoqërore që të gjejnë dhe të ecin rrugës së drejtë, e cila fundin e ka te dera e Xhennetit.

Në këto kohë dhe në këtë vend, shqetësimi për të rinjtë duhet jetë prioritet prej prioriteteve tona kryesore.

(Hytbeja e xhumasë, mbajtur në xhaminë "El-Hidaje" në St. Gallen të Zvicrës, më 31.01.2014)



## SHKODËR, NIS PËRKUJTIMI I LINDJES SË HZ. MUHAMMEDIT (A.S)

**D**itën e xhuma, më 10 janar 2014, nëpërmjet minberit të xhamisë së Parrucës, Myftiu i Shkodrës Imam Muhamed Sytari, ka lajmëruar të pranishmit e shumtë, për afrimin e datës 12 Rebiulevel, që përkon me datën 13 janar 2014, ditë në të cilën mbarë bota islame përkujton Lindjen e Begatë të Hz. Muhammedit (a.s).

Nëpërmjet hytbes së kësaj xhujmaje, Myftiu ka dhënë mesazhet e tij në lidhje me këtë datë të shënuar për njerëzimin, jo vetëm për muslimanët, duke iu referuar ajeteve kur'anore, nëpërmjet të cilave theksohet qartë dërgesa e Hz. Muhammedit (a.s), si mëshirë për mbarë botrat dhe si i dërguar i fundit dhe vulë e profetësisë.

Myftiu ka theksuar se përkujtimi i kësaj date është një detyrim moral dhe një shenjë respekti ndaj të dërguarit (a.s), si dhe një domosdoshmëri për të tërhequr vëmendjen e botës drejt begative hyjnore që lidhen me personalitetin e Hz. Muhammedit (a.s) dhe dërgesën e tij profetike.

Në këtë hytbe, Myftiu ka theksuar se falë Zotit, shqiptarët e përqaftuan Islamin, me vullnet të plotë dhe sot dëshmohen si një popull musliman, që mbi bazat e Kur'anit dhe mësimet e Hz. Muhammedit (a.s), respekton, toleron, bashkëjeton dhe bashkëpunon edhe me besimtarët e tjerë, me të cilët ndan së bashku një tokë e një qiell.

Me rastin e përkujtimit të kësaj date të shënuar, Myftinia Shkodër ka planifikuar disa aktivitete, në shërbim të gjallërimit të mëtejshëm të mesazheve që përcjell përkujtimi i lindjes dhe personalitetit të Hz. Muhammedit (a.s).

## AKTIVITETI FETAR: “NË GJURMË TË RESULULL-LLAHUT (A.S)”



**D**itën e hënë, më 13 janar 2014, pas namazit të iqindisë, në përkujtim të Lindjes së Begatë të Hz. Muhammedit (a.s), Myftinia Shkodër ka zhvilluar një aktivitet fetar në xhaminë e Parrucës.

Aktiviteti ka nisur me leximin e një pjese kur'anore nga Hafiz Ramazan Avci, pas së cilit teologu Arben Haluni ka bërë hapjen e këtij tubimi, duke vënë theksin te mirësia e këtyre tubimeve, në përkujtim të personalitetit të Profetit tonë dhe mesazheve të fesë islame.

Në fjalën e tij, Myftiu i Shkodrës Imam Muhamed Sytari, ka tërhequr vëmendjen e të pranishëmve se përkujtimi i Lindjes së Profetit (a.s), është një domosdoshmëri për muslimanët, sidomos në kohëra, kur kushtet e jetesës bëhen shkak dhe pengesë që njerëzit të lidhen si duhet me përkujtimin e tij (a.s).

Myftiu i është referuar ajeteve

kur'anore dhe haditheve, nëpërmjet të cilave, dijetarët kanë nxjerrë konkluzionet e duhura që nxisin përherë e më shumë këto tubime, si tregues të dashnisë dhe vullnetit për të ndjekur traditat profetike.

Imami i xhamisë së Parrucës, teologu Naim Drijaj, ka folur për modelin e sahabëve në pasimin me dashuri të Resulull-llahut (a.s), duke theksuar se ai ishte më i dashur për ta, se edhe vetë vetja e tyre.

Imami i nderuar ka përmendur shembuj të ndryshëm, nëpërmjet të cilëve ka përkufizuar madhësinë e Profetit dhe lidhjen e fortë e të pashembullt, që sahabët kishin me Zotërinë e tij.

Më pas, teologu Resmi Likaj, mësuesi Orhan Dani dhe H. Ramazan Avci, kanë kënduar disa ilahi të bukura dhe pjesë mevludi, që ia kanë shtuar bukurinë këtij tubimi vlerash.



## SALAVATET MBULUAN SHKODRËN NË NJË NATË ME DRITË BESIMI

**M**brëmjen e së mërkurës, më 15 janar 2014, Myftinia Shkodër ka organizuar një aktivitet fetar e kulturor në teatrin "Migjeni", në përkujtim të Lindjes së Begatë të Hz. Muhammedit (a.s) dhe mesazheve të mëshirës dhe mirësisë, me të cilat u dërgua si i fundit i profetëve të All-llahut.

Aktiviteti që kishte tejmbushur sallën e teatrit, nisi me shfaqjen e filmit më të ri të prodhuar nga Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, në lidhje me dërgesën profetike dhe misionin global me të cilin u dërgua Hz. Muhammedi (a.s).

Më pas, për rreth dy orë, të pranishmit kanë ndjekur programin e pasur me ligjërrata e përshëndetje, ilahi, recitime e salavate, në nderim dhe përkujtim të Hz. Muhammedit (a.s).

Në fjalën e tij para të pranishëmve, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed Sytari, iu drejtua me disa fjalë të ngrohta, plot prekje malli e dashurie, Profetit Muhammed (a.s), duke e mbyllur fjalën e tij me një salavat, që u shoqërua nga krejt të pranishmit.

H. Bujar Spahiu, nënkryetar i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, përcolli para të pranishëmve sela-

met dhe përshëndetjet e Kryetarit të KMSH, H. Selim Muça. Në fjalën e tij, u përqendrua edhe te rëndësia e dërgesës profetike të Hz. Muhammedit (a.s) dhe vlera e madhe e traditave profetike, si një udhëzim i përhershëm për brezat muslimanë dhe njerëzimin.

Aktiviteti u pasuar me ilahitë e bukura dhe salavatet e kënduara me profesionalizëm nga "Grupi i ilahive" i Universitetit BEDËR, nën drejtimin e z. Davud Aktepe.

Një moment emocional ishte edhe recitimi i poezisë "Lindja e Muhammedit (a.s)", shkruar në vitin 1932 nga z. Hysni Bushati, të cilit iu akordua edhe titulli: "Mirënjohja e Qytetit". Në emër të familjes, shkrimtari Xhahid Bushati falënderoi Myftininë Shkodër dhe Këshillin e Bashkisë për këtë nderim për të atin dhe ringjalljen e kujtimit të mirë që ai la.

Të pranishëm në këtë aktivitet ishin edhe Kryetari i Bashkisë Shkodër, z. Lorenc Luka, Kryetari i Këshillit të Bashkisë, z. Bardhyl Lohja, Kryetari i Këshillit të Qarkut Shkodër, z. Maxhid Cungu, antarët e Kryesisë së KMSH, z. Genti Kruja dhe z. Uran Kalej, drejtues të medreseve, shoqatave të ndryshme partnere etj.



## EMISIONI "HAPUR" NË TV1, MBI JETËN E HZ. MUHAMMEDIT (A.S)

**M**brëmjen e së enjtes, më 16 janar 2014, në emisionin "Hapur", në Tv1 Channel, ka qenë i ftuar Myftiu i Zonës Shkodër, Imam Muhamed Sytari, në një bashkëbisedim mbi jetën dhe misionin e Hz. Muhammedit (a.s).

Në përgjigje të pyetjeve të gazetarit Simon Shkreli, Myftiu ka folur fillimisht rreth rëndësisë që ka përkujtimi i lindjes së begatë të Hz. Muhammedit (a.s), si njeriu profet, vula e vëllezërve të tij profetë, të cilët u dërguan ndër shekuj, me qëllim përmirësimin e rrugëtimit të njeriut në këtë jetë, si mëkëmbës i Zotit.

Myftiu ka theksuar se me ardhjen e Hz. Muhammedit (a.s), njerëzimi u begatua me shpalljen e fundit dhe mbylljen e dërgesave hyjnore, duke u bërë profeti i parë dhe i vetëm me mision global, jo thjesht për një popull a një fis.

Gjatë këtij emisioni është folur edhe mbi rëndësinë që kanë mësimet e Profetit Muhammed (a.s) për njerëzit e kësaj kohe, sidomos pas shfaqjes së degradimit të moralit të besimit, mirëkuptimit dhe respektit të njeriut për vëllanë e tij njeri.

Myftiu i është përgjigjur edhe pyetjeve të ndryshme të ardhura në lidhje me temën dhe me përmbajtjen e saj, duke vënë theksin te rëndësia e mirëkuptimit të koncepteve islame dhe largimin nga keqinterpretimet që shkaktojnë devijim dhe sjellje të papranueshme nga vetë feja.

Në përfundim të këtij bashkëbisedimi Myftiu ka uruar që njerëzia dhe shqiptarët në mesin e tyre, të kthehen me zemër e pastërti nga besimi, duke vlerësuar Fjalën e Zoti dhe duke jetuar në paqe e mirëkuptim me njëri-tjetrin, pavarësisht diversitetit.



**M**e ftesë të Bashkësisë Islame "El-Hidaje", në St. Gallen të Zvicrës, gjatë periudhës 17-20 janar 2014, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed Sytari, ka marrë pjesë në aktivitetet e ndryshme fetare, me rastin e përkujtimit të Lindjes së Begatë të Hz. Muhammedit (a.s).

Fillimisht, Myftiu është pritur nga Kryetari i B.I. "El-Hidaje", z. Qemal Rushiti dhe imami H. Mehas Alija, me të cilët ka ndarë kënaqësinë e këtyre takimeve, në të cilët këmbëhen eksperiencia dhe forcohen urat e bashkëpunimit në mesin e muslimanëve shqiptarë. Më këtë rast, Myftiu i ka dhuruar B.I. "El-Hidaje", një kontigjent me botimet e fundit që Myftinia Shkodër ka përgatitur me rastin e përkujtimit të sivjetshëm të Lindjes së Hazreti Muhammedit (a.s) dhe misionit të tij për mbarë botërat.

Ditën e xhuma, më 17 janar 2014, Myftiu ka mbajtur edhe një ligjëratë para namazit të xhumasë, në xhaminë "El-Hidaje", ku i është drejtuar të pranishëmve mbi vlerën dhe rëndësinë që ka përjetimi i traditave profetike të Hz. Muhammedit (a.s) në jetën e përditshme të muslimanit.

Ndërkohë, të shtunën, më 18 janar 2014, Myftiu ka zhvilluar një vizitë zyrtare në selinë e Forumit të Rinjve Muslimanë në St. Gallen, ku është pritur nga Kryetari i FRM, z. Sherif Roçi me bashkëpunëtorë. Gjatë kë-

## ZVICËR, TRIBUNA FETARE KUSHTUAR RESULLULL-LLAHUT (A.S)

saj vizite, është diskutuar edhe mbi domosdoshmërinë e rritjes së bashkëpunimit në mesin e institucioneve islame shqiptare dhe mbrojtjen me dije dhe urtësi të frymës së paqtë të përhapjes së Thirrjes Islame me urtësi e mesatarizëm në mesin e besimtarëve.

Po atë ditë, pas namazit të jacisë, Myftiu ka marrë pjesë në tribunën fetare të organizuar nga xhamia "Al-Shems", në Rebstein, ku ka ligjëruar rreth mbrojtjes hyjnore me të cilën është rrethuar personi i Hz. Muhammedit (a.s).

Myftiu ka qenë i ftuar nderi në tribunën tradicionale të zhvilluar nga B.I. "El-Hidaje", të dielën, më 19 janar 2014. Në një mjedis të begatuar nga pjesëmarrja e besimtarëve të shumtë, imamëve të Qendrave Islame Shqiptare në Zvicër, si dhe prezenca e ambasadorit të Republikës së Maqedonisë në Zvicër, z. Ekrem Ebibi, të shumta kanë qenë recitimet, ilahitë dhe salavatet që ia kanë shtuar bukurinë këtij tubimi. Pa dyshim, kjo tribunë është zbukuruar edhe nga salavatet dhe ilahitë e shfaqura nga kori i fëmijëve të xhamisë dhe nga recitimi i z. Burim Berisha, kushtuar mallit ndaj

të Dërguarit (a.s).

Në këtë ktribunë, Myftiu ka ligjëruar rreth temës: "Çfarë përfitoi bota me ardhjen e Muhammedit (a.s.)", ku është fokusuar tek përhapja e mëshirës së tij (a.s) për këdo e gjithçka.

Ndërkohë, Bashkësia Islame "El-Hidaje" i ka akorduar Myftiut të Shkodrës Imam Muhamed Sytari një "Mirënjohje", me dedikimin: "Në cilësinë e "Thirrësit islam", për kontributin e tij të pashoq në zhvillimin e mendimit islam, respektivisht në mbrojtjen dhe kultivimin e trashëgimisë sonë islamo-shqiptare".

Po atë ditë, pas namazit të jacisë, Myftiu ka qenë ligjërues edhe në tribunën e zhvilluar nga xhamia "Buhara", në Kradolf.

Me këtë rast, Imam Muhamed Sytari ka hedhur dritë mbi nevojën që ka sot bota islame për nxitjen e dashurisë ndaj të Dërguarit (a.s), si rrugë drejt dashurisë për Zotin e Madhëruar.

Pas përfundimit të tribunës, Myftiu ka zhvilluar edhe një bashkëbisedim të ngrohtë e vëllazëror, të shoqëruar me pyetje-përgjigje të ndryshme, me të rinjtë e xhamisë dhe xhematin e saj.



## “Dëshmitar në Sahar...”, kujtime nga një Umre e begatë...

**K**ëto ditë ka dalur nga shtypi libri më i ri i autorit Muhammed Sytari, me titull: “Dëshmitar në Sahar”, në të cilin janë mbledhur e rreshtuar kujtimet e Umres së kryer në periudhën 1-7 mars 2013, në të cilat autori është vetë personazh dëshmues.

Që në krye të herës, autori ka shënuar arsyen se pse ky libër duhej të dilte në dritë, që është pikërisht ai përjetim i madh dhe ajo eksperiencë e pashembullt shpirtërore, që rrethon cilindo besimtar që Zoti ia mundëson udhëtimin drejt venedeve të shenjta, në Mekë dhe Medine.

Në një vëllim prej 80 faqesh, autori ka mbajtur shënime të shumta, të shoqëruara me përjetime personale, kujtime në shoqërinë më të mirë, pse jo dhe një vështrim historik që lidhet me emra vendesh, personash të shquar, ngjarjesh e ndodhishë të rëndësishme të historisë islame.

Libri “Dëshmitar në Sahar” është botim i Shtëpisë Botuese “Progresi”, Shkodër.

## "Hz. Muhammedit (a.s), dhurata më e madhe që Zoti i ka bërë njerëzimit!"

**T**ë xhumanë, më 24 janar 2014, Myftiu i Shkodrës ka mbajtur hytben e radhës nga minberi i xhamisë së Tophanës. Në qendër të kësaj hytbeje ka qenë nxitja për mbrojtjen e identitetit islam nëpërmjet thellimit në modelin e Hz. Muhammedit (a.s), si dhurata më e madhe që Zoti i ka bërë njerëzimit.

Myftiu ka folur edhe mbi rëndësinë që ka zgjimi i vetëdijes islame në

Faleminderit Komandant Hasan Riza Pasha!  
Udhëhoqe me trimëri muslimanët e Shkodrës,  
me hoxhallarët e tyre në krye,  
në betejet e mbrojtjes së nderit  
dhe dinjitetit të Shkodrës,  
kundër armiqve të pavarësisë së Shqipërisë...  
Tashmë, ti je lartësuar si Shehidi i Shkodrës  
dhe Komandanti i saj!  
Qofsh i Firdeusit, Komandanti i jonë!



ndërgjegjen e muslimanit shqiptar, për të mos pasur ndrojtje në rrugën e mbrojtjes së identitetit të tij islam, aq më shumë në këto kohë, kur – siç ka theksuar Myftiu: “Është shtuar dukshëm dukuria e islamofobisë dhe një tendencë e çmendur për të abuzuar me historinë e identitetit fetar të shqiptarëve. Në të gjitha trojet tona, po shohim sot, një luftë të fëlliqtë mediatike dhe politike, në rrugën e devijimit të përkatësisë fetare të shqiptarëve dhe një abuzim të ulët ndaj Islamit dhe shpirtit të tij.

Ne, si muslimanë, kemi respekt dhe nderim për të gjithë besimtarët dhe përkatësinë e tyre fetare, por në

asnjë mënyrë nuk mund të tolerojmë këtë propagandë idhujtare e pagane, që po abuzon me realitetin e shpirtit dhe besimit të shqiptarëve. Ne jemi muslimanë dhe nuk mund ta shesim as ta ndrojmë fenë tonë për asnjëri në botë!”.

Në hytben e kësaj xhumaje, Myftiu ka hedhur dritë mbi shembullin e Hz. Muhammedit (a.s) në marrëdhëniet e tij me brezin e ri, duke iu referuar argumenteve të shumta që prezantojnë modelin më të mirë të një prindi shembullor, një gjyshi të mëshirshëm e një burri të madh, që diti të vendosë të drejtat e gjithëkujt në vendin e duhur.



**P**araditën e së shtunës, më 25 janar 2014, në xhaminë e Rusit u organizua një aktivitet përkujtimor në nder të muezinit dhe imamit rahmetli të xhamisë Rus, H. Hamza Cungu, i cili u nda nga jeta vitin e kaluar.

Fillimisht, imami i xhamisë Rus, H. Fejzi Zaganjori, falënderoi të pranishmit për pjesëmarrjen e tyre dhe vlerësoi se ky aktivitet vjen si një ndjenjë mirënjohje dhe respekti në drejtim të njërit prej personaliteteve të shquara të kësaj xhamie dhe Myftinisë Shkodër, në dy dekadat e fundit.

Ndërkohë, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed Sytari, në fjalën e mbajtur para të pranishëmve, ka vlerësuar shembullin pozitiv të H. Hamza Cungut, të cilin e ka cilësuar si një njeri të bardhë, prej të cilit të gjithë kanë përfituar, qoftë nga urtësia e tij, buzëqeshja prindërore, këshilla e matur e puna në heshtje në shërbim të xhamisë dhe komunitetit.

Myftiu ka theksuar se modele të tilla, janë përherë shembuj inspirues për të sotmen, për të kuptuar madhësinë e të qenurit musliman; njeri i pastër, i ditur, i urtë, i heshtur në veprim, përherë i fortë në vetëvete me besimin në Një Zot të Vetëm

## PËRKUJTIMORE NË NDER TË H. HAMZA CUNGUT



e të Vërtetë!

Më pas, H. Fejzi Zaganjori ka mbajtur një fjalë, në të cilën ka nxjerrë në pah vlerat dhe vetitë pozitive të H. Hamza Cungut, si një njeri që vuajti 24 vjet në burgjet komuniste, që sakrifikoi në rrugën e besimit dhe fesë islame dhe që nuk u dorëzua as-

njëherë së kontribuari për të mirën e komunitetit besimtar musliman, me shërbime konkrete në xhaminë e Rusit, por jo vetëm.

Të pranishmit kanë dëgjuar edhe disa vlerësime për rahmetliun, nga z. Vehbi Hoti, që ka lexuar disa vargje me dedikim për H. Hamza Cungun. Ndërkohë, të gjithë kanë dëgjuar me vëmendje dhe nostalgji disa regjistrime të vjetra, në të cilat H. Hamza Cungu këndon disa ilahi të hershme, plot patos dhe emocion besimi.

Për shpirtin e tij është bërë edhe dua e hatmes, që është pasuar nga përshëndetja e bërë në emër të familjes, nga z. Maxhid Hamza Cungu. Në fjalën e tij, ai ka falënderuar këtë vlerësim që i bëhet babës së tij, duke vlerësuar frymën e respektit ndaj besimit dhe besimtarëve në xhamitë e Shkodrës.


Të pranishmit kanë falur së bashku edhe namazin e drekës dhe janë përshëndetur, me vlerësime pozitive për organizimin e këtij aktiviteti përkujtimor në nder të një njeriu të mirë, si H. Hamza Cungu.

**“Është shtuar dukshëm dukuria e islamofobisë dhe tendenca e çmendur për të abuzuar me historinë e identitetit fetar të shqiptarëve. Në të gjitha trojet tona, po shohim sot, një luftë të ulët mediatike dhe politike, në rrugën e devijimit të përkatësisë fetare të shqiptarëve dhe një abuzim të hapët ndaj Islamit dhe shpirtit të tij.**

**Ne, si muslimanë, kemi respekt dhe nderim për të gjithë besimtarët dhe përkatësinë e tyre fetare, por në asnjë mënyrë nuk mund të tolerojmë këtë propagandë idhujtare e pagane, që po abuzon me realitetin e shpirti dhe besimit të shqiptarëve. Ne jemi muslimanë dhe nuk mund ta shesim as ta ndërrojmë fenë tonë për asnjeri në botë!”**

**- Imam Muhamed Sytari, nga hytbeja e xhumasë, më 24. 1. 2014.**





# “BULETIN”, NR. 3

**Botues:**  
Myftinia Shkodër  
**Drejtues:**  
Imam Muhamed Sytari

**Dizajn & Grafik:**  
Bledar Xama

**Tel / Fax:**  
+355 (0) 224 2081  
**Nr. llogarie:**  
100054 UBA - Shkodër

**E-mail:**  
udhaislame@myftinia-shkoder.org  
**Website:**  
www.myftinia-shkoder.org